



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2126

NR. VENDIMI 9583

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

Gjyqtare -----Rezarta MATAJ

me sekretare gjyqësore Ina Serjanaj, në Tiranë, sot më **25 nëntor 2016**, ora **10:30**, mori në shqyrtim në disa seanca gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile që i përket

Paditës:

***, e bija e *** dhe e ***, e datëlindjes ***, lindur dhe banuese ne ***, e ve, me dy fëmië arsim i lartelë, pensioniste, shtetësi shqiptare. i mbrojtur ne gjykim nga Av. ***

antarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë, i zgjedhur me prokurë të posaçme.

I paditur: 1. ***, i biri i *** dhe i ***, i datëlindjes ***, lindur ne *** dhe banues ne ***, i martuar, arsim i lartë, shtetësi shqiptare. I përfaqësuar me prokurë të posaçme noteriale nga av. *** antarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

2. ***, i biri i *** dhe ***, datëlindjes. ***, lindur ne *** dhe banues ne ***, i martuar, arsim i lartë, shtetësi shqiptare. i përfaqësuar me prokurë të posaçme noteriale nga av. *** antarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Person i Tretë: 1. Shtëpia botuese ***, me seli ne ***, perfaqesuar me administratore *** e përfaqësuar nga av. *** antarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë, i zgjedhur me deklaram në seancë.

2. Zyra Shqiptare per te Drejten e Autorit (Në mungesë).

Me objekt:

I ndryshuar

1. Kundershtim i bashkeautorsise te te paditureve *** dhe *** mbi vepren fjalor shprehjesh frengjisht – shqip te vitit 2008 (1000 shprehje me te perdorshme ne

frengjishten e sotme) dhe 2. Njohjen e autoresise mbi kete veper te autorit *** në 42% të volumit të saj (ose 42% të shprehjeve më të përdorshme në frëngjishten e sotme);

Baza ligjore :

Neni 58 i Kushtetutes i Republikes se Shqiperise, neni 1, 4, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, 21, 118, 120, 121, 122, 123, 127, 128 te Ligjit numer 9380, date 28.04.2005 “Per te Drejten e Autorit dhe te Drejta te tjera te lidhura me te”; nenet 608, 609, 640 te Kodit Civil dhe nenet 31, 32, 202 e vijues te Kodit te Procedures Civile.

Nëbisedimet përfundimtare përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse u shprehën:

- Av. *** dhe ***: ” *Pranimin e padisë sipas objektit*”;
- Pala e paditur *** i përfaqësuar nga av. **, i padituri *** dhe personi i tretë shoqëria botuese «***» kërkuan: ” *Rrëzimin e padisë si e pambështetur në ligj dhe në prova.* ”
- Personi i tretë Zyra Shqiptare për të drejtën e autorit në mungesë.

Gjykata pasi mbylli hetimin gjyqësori, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brendshme

VËRËNJE

1. Paditësi *** idrejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (GJRRGJ Tiranë) me kërkesë-padinë ndaj të paditurve *** dhe *** me shkak ligjor si në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Objekti fillestar i objektit të padisë ishte: «Kundershtim i bashkeautorsise te te paditureve *** dhe *** mbi vepren fjalor shprehjesh frengjisht – shqip te vitit 2008 (1000 shprehje me te perdorshme ne frengjishten e sotme) dhe njohjen e autoresise mbi kete veper te autorit *** dhe per rrjedhoje shperblimin e demit moral te ardhur nga mosnjohja e autorsise ne masen *** leke; Marrjen e mases se sigurise duke vendosur “bllokimin e te gjithe kopjeve te vepres fjalor shprehjesh frengjisht – shqip te vitit 2008 me bashkeautore *** dhe ***.» Objekti me kërkesë të paditësit u pakësua vetëm në dy kërkimet e para duke u saktësuar masa e bashkëautorsisë së pretenduar.
2. Kjo çështje vjen për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë e cila me vendimin nr. *** datë vendimi *** ka vendosur prishjen e vendimit nr. *** datë *** të GJRRGJ Tiranë me arsyetimin se ka pasur shkelje procedurale si munges e nënshkrimit të sekretares në procesverbalin e seancës dhe faktit se është marrë në cilësinë e ekspertit një dëshmitar i mëparshëm.
3. Gjykata sipas nenit 36, 41,42 të Kodit të Proçedurës Civile (më tej KPRC) dhe nenit 7 §1 i Kodit të Punës (më tej KP) ka juridiksionin gjyqësor, kompete -ncën tokësore dhe lëndore në gjykimin e kësaj kërkesë-padie pasi vëndbanimi i palës së paditurështë pjesë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo është e parashikuar edhe në nenin 13.1 të kontratës së punës individuale datë 15 tetor 2013.

II. Mbi faktet dhe rrethanat e çështjes

4. Paditësja është trashëgimtare ligjore e të ndjerit, autorit të njohur të përkthimeve të gjuhës frënge Z. *** sipas Vendimit nr.3065, date 26.09.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane.
5. Të paditurit janë pedagoge pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti

i Tiranës, Departamenti i gjuhës frënge dhe autor të botimeve në fushën e përkthimit frëngjisht-shqip.

6. Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tiranës *** është autor i vepres Fjalor Frëngjisht Shqip i vitit 2001 me 35.000 fjale “Botimet ***” dhe i Fjalorit Frëngjisht Shqip, Shqip- Frëngjisht te vitit 2002 me 43.000 fjale dhe shprehje, “Botimet ***”.

7. Te paditurit *** dhe *** jane bashkeautore te vepres Fjalor shprehjesh Frëngjisht Shqip “1000 shprehje me te perdorshme ne frëngjishten e sotme”, botim i cili eshte realizuar nga Shtepia Botuese “***” (2008).

8. Paditësja pretendon se nga dy fjaloret e të atit janë vjelur, marrë 42 % të shprehjeve dhe janë përfshirë në Fjalorin e dy të paditurve duke e shfrytëzuar punën e tij që nga 2008 pa i njohur asnjë të drejtë vetjake apo pasurore.

9. Të paditurit prapësuan se nuk kemi shkelje të së drejtës së autorit pasi shprehjet frazeologjike ose shprehjet popullore përjashtohen nga mbrotjia e së drejtës së autorit por janë pronë e të gjithë popullit shqiptar, po ashtu vetë *** nuk është shpikës as i shprehjeve të frëngjishtës dhe as i shprehjeve në gjuhën shqipe dhe ai vetë i ka marrë në një fjalor tjetër.

10. Në Gjykim u caktuan në cilësinë e ekspertit të vetmit personae të cilët plotësonin kushtet e ekspertëve të kërkuar nga palët konkretisht të diplomuar në profilin frëngjisht, përkthim, me titullin Prof. Dr ose Prof. Asoc. Dr (pasi sipas të paditurit *** duke pasur titull akademik shkencor nuk mundet që eksperti të ketë nivel akademik më të ulët se ai pra të gjykoj «kapterri gjeneralin» shih procesverbalin e seancës) si dhe të mos jetë i punësuar pranë Universitetit të Tiranës ku punojnë të paditurit. Në këto kushte pas të gjitha shkresave që gjykata u dërgoi Ministrisë së Arsimit, Të gjithë Universiteteve në të gjithë Republikën, Akademisë së Shkencave rezultuan të vetëm shtetas që plotësonin kriteret e mësipërm: Prof. Dr. ***, Prof.Dr. *** të dyja nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Prof.Asoc. Dr ***- Universiteti i Gjirokastrës.

11. Mbi pyetjet dhe detyrat që gjykata u shtroi palëve rezultuan nga akti herë a botuar ndonjë fjalor të shprehjeve frazeologjike frëngjisht-shqip. Përveç ***, ****t dhe ***, ka pasur përpunues dhe botues të tjerë të fjalorëve dy gjuhësh frëngjisht-shqip si: *** (2010), *** (1998), ***. Vetë *** ka botuar fjalor dygjuhësh frëngjisht-shqip, përpara këtyre fjalorëve në vitin 1966 dhe në 1989 -Shprehjet e pretenduar si te kopjuara janë praqitur të nenvizuar me ngjyrë kuqe në fjalorin ***-*** nga vetë pala paditëse, ngjashmëria e shprehjeve frazeologjike mes dy fjalorëve është në masën 6% - tabela iI, ndërrsa barasvlefshmëria në masën 11% - tabela i ndërsas në korpusin e gjegjësvë shqip, shembuj dhe shpjegime të nrsyhme përkim në nivel fjale është 3.8 % - Tabela V.)

Ndërsa mbivendosje në nivel mikrostruktore dhe mbivendojse në mikrostrukturë në të gjitha hyrjet/zerat leksikografikë është zero.

- Fjalori i *** është fjalor i përgjithshëm ndërsa fjalori ***-*** është fjalor specifik, kufizues. Këto dy fjalorë paraqesin dallime në rrafshin strukturor, në mikrostrukturë dhe makrostrukturë, rënditja e fjalëve, synimi, objekti, publiku, numri i njësive hyrëse etj. *** në fjalorin e tij është mbështetur tek fjalorët

Larousse

Të dy fjalorët janë të ndryshëm nga titulli, objekti i studimit, mëna e paraqitjes së shprehjes frazeologjike (në fjalorin e parë paraqitet vetëm fjalë hyrëse dhe njësitë frazeologjike ndërsa në fjalorin e dytë paraqiten fjala bazë, shpjegime,

shënime, shembuj në fregjisht dhe shëmbuj të shqipes)

- Në fjalorin e *** dhe *** ka 310 shprehje që nuk gjendet në fjalron e ***.
- Shprehjet frazeologjike janë krijime anonime, kryesisht të gjuhës së folur dhe nuk kanë autorsi prandaj ato klasifikohen si shprehjet popullore. Asnjëri nga autorët nuk ka autorisinë dhe monopolin e shprehjeve frazeologjike të shqipes. Buriat e shprehjeve frazeologjike të shqipes është gjuha amtare, populloi, studime, leximet, profesioni, fjalori i shqipers, kompetenca gjuhësore etj.
- Pala paditëse ka marrë si metodë për konkluzionin se ka ngjashmëri është e gabuar pasi fjalët i ka marr të shkëputur nga konteksti dhe vendos shenjën e barazisë 1 me 1 duke harruar se në të dyja mikrostruturat ka edhe barasvlerës të ndryshëm;
- Vepra e ***-*** nuk përfaqëson as riprodhim pjesor dhe as tërësor të fjalorit *** por ajo përbën krimtari vetjake duke u nisur nga ristë që ka: karakteri evolues i gjuhës, vajtje-ardhje nga shprehja tek kuptimi dhe nga kuptimi tek format, karakteri i theksuar didaktik, krijimi i shëmbujve, përkthimin e tyre në gjuhën shqipe etj. »

12. Me kërkesë të palës paditëse ekspertëve iu caktua edhe disa detyra shtesë të cilët iu përgjigjën në këtë mënyrë: «Shifra 11% nënkupton numrin e shprehjeve identike me ato që figurojnë në të dy fjalorët, 6% paraqiten shprehje të ngjashme pra ngjashmëri në nivel shprehje, ngajshmëri në nivel mikrostrukture është zero pra për të gjitha zërat leksikografik ku mikrostruktura përbëhet nga shprehje në të nuk ka asnjë identicitet. »

III.Legjislacioni i zbatueshëm

13. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 58

“1. Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.

2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.”

14. Ligjin nr.9380, date 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te drejttat e tjera te lidhura me te

Neni 4

“1. “Vepër artistike” është çdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik, i materializuar, pavarësisht nga forma a mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të prekë ndjesitë e njeriut.

2. “Vepër artistike e prejardhur” është çdo krijim intelektual, i cili e ka prejardhjen nga një vepër origjinale, por pa e cenuar atë. “

...

27. “Botues” është personi fizik a juridik, që merr nismën dhe realizon, nën përgjegjësinë e vet, riprodhimin mekanik dhe vënien në dispozicion të publikut të një vepre, me çdo mjet a mënyrë.”

Neni 5 Autorësia

“1. Autor/ë është personi ose janë personat fizikë, që krijojnë një vepër letrare,

artistike ose shkencore.

2. Autor i veprës është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, me emrin e të cilit/ve vepra është shfaqur për herë të parë në publik, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se autorësia i përket një ose disa personave fizikë, të tjerë nga ata që kanë emrat në vepër. ...”

Neni 6-Bashkautorët

“1. Vepër e përbashkët është puna krijuese e disa autorëve në bashkëpunim. 2. Bashkautorësia rregullohet me marrëveshje ndërmjet palëve ose sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. 3. E drejta e autorit në veprën e përbashkët u përket autorëve, të cilët me marrëveshje zgjedhin njërin prej tyre si autorin kryesor.”

Neni 7

“Objekt i të drejtës së autorit në fushën e letërsisë, artit ose shkencës, produkt i punës krijuese të mendjes së njeriut, pa marrë parasysh mënyrën e krijimit, mjetet ose format praktike të të shprehurit dhe pavarësisht nga vlerat e tyre ose destinacioni, janë:

- a) shkrimet letrare dhe publicistike, leksionet, predikimet fetare, çdo krijim tjetër, gojor ose me shkrim, dhe programet e kompjuterit;
- b) krijimet shkencore, me shkrim ose me gojë, si për shembull: leksionet shkencore, studimet, leksionet universitare, librat shkollorë, programet kompjuterike, projektet dhe dokumentacioni shkencor;...”

Neni 8 Veprat e prejardhura

“1. Objekt i të drejtës së autorit janë edhe: a) veprat e prejardhura, të cilat, pa cenuar të drejtat e autorit të një vepre, krijohen duke filluar nga një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, në mënyrë të veçantë: përkthimet, përshtatjet, ilustrimet, krijimet dokumentare, aranxhimet muzikore dhe çdo transformim i një vepre letrare, artistike a shkencore, produkt i punës krijuese...”

Neni 9 Rastet e përjashtimit

“Nuk janë objekt i të drejtës së autorit dhe nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj:

- a) idetë, teoritë, konceptet, zbulimet dhe shpikjet në një vepër krijuese, pavarësisht nga mënyra e marrjes, e të shpjeguarit ose e të shprehurit;
- b) tekstet zyrtare, të natyrës juridike, administrative, legjislative, politike, si dhe përkthimet zyrtare përkatëse; c) simbolet zyrtare të shtetit, të organizatave dhe autoriteteve publike, si për shembull: armët, vula, flamuri, emblemat, medalioni, shenja dalluese, medalja;
- ç) mjetet e pagesës;
- d) lajmet dhe informacioni i shtypit;
- dh) të dhënat dhe faktet e thjeshta;
- e) shprehjet popullore. “

IV. Vlerësimi i gjykatës mbi bazueshmërinë e padisë mbi ligj dhe provat

16. Gjykata duhet të analizoj në fillim pronësinë e palës paditëse mbi dy veprat artistike, shkencore dhe nga ana tjetër nëse vepra e të paditurve ka cënuar veprën e paditësit apo jo. Pronarit të një vepre i njihet e drejta e shfrytëzimit të saj në mënyrë ekskluzive (neni 13), ta modifikoj veprën, ta shpërndajë atë, të kundërshtoj bashkëautorisinë në një vepër apo të kërkoj vendosjen e emrit të saj në një vepër (neni 10) etj.

17. Së pari- Autori *** është i njohur në fushën e përkthimeve nga gjuha frëngë në atë shqipe në Shqipëri, ai është autori i fjalorëve të njohur frengjisht-shqip që nga vitit 1966, 1989 dhe më Fjalor Frengjisht Shqip i vitit 2001 me 35.000 fjale “Botimet ***” dhe i Fjalorit Frengjisht Shqip, Shqip-Frengjisht te vitit 2002 me 43.000 fjale dhe shprehje, “Botimet ***”. Të gjitha këto fjalor të përgjithshëm.

18. Nga ana tjetër *** nuk është asnjë herë autor i një fjalori specifik mbi shprehje frazeologjike nga frengjishtja në shqip. Në këto kushte identiteti i fjalorëve ngushtohet në verifikim nëse përmbajtja të njërit apo tjetrit fjalor janë identike apo jo.

17. Së dyti- Paditësja, trashëgimtarja e autorit pretendon se 42% veprës së babait të saj në dy fjalorët e vitit 2001 dhe 2002 janë marrë dhe përthithur tek fjalori *** dhe ***.

18. Gjykata konstatoi se fjalori ndërtohet jo në bazë shprehjesh por në bazë mikrostrukture ku si e tillë konstatohet tërësia e shprehjeve, ilustrimeve ,shëmbujve në frengjisht dhe në shqip për një fjalë përkatëse të gjuhës së huaj. Konkretisht e ilustruam me një shëmbull: Pas (faqja 737 e fjalorit të 2001 të V.K) emër nënkupton (n) hap, çap dhe më pas jepen edhe 6 kuptime të tjera të saj duke u ilustruar nga autori me tog fjalëshe, shprehje frazeologjike etj. Nga ana tjetër në kuadrin e shprehjeve frazeologjike nga bashkëautorët *** dhe *** 2008 ka këtë mikrostrukturë- faire les cent pas, bëj ecejake, lëviz tutje- tëhu (në pritje të diçkaje), Le train n’arrivait que dans unë heure et jái passe le temps a faire les cent pas devant la gare. Treni do të mbërrinte vetëm pas një orë dhe kalova kohën duke lëvizur tutje-tëhu nëpër stacion. A deux pas- Dy hapa larg, as dy minuta larg, një vrap pele, fare pranë. Cés a deux pas d’ici = një vrap pele larg: Është akoma larg stacioni i treni?(Do dhe shumë të mbërrijmë të stacioni i trenit?)- Jo, ja arritëm, dy hapa larg është prej këtu (faqe 119).

19. Vërehet se në mikrostrukturë asgjë nuk është e përbashkët mes të dy fjalorëve prandaj ekspertët kanë konkluduar se ka zero ngajshmëri apo identitetet mes fjalorëve të *** dhe fjalorit të ***t dhe ***t. Ndërsa i gabuar është pretendimi i palës paditëse ku pretendon autorisinë me arsyetimin se në mikrostrukturën “pas”, faqe 737 të fjalorit të 2001 në brëndësi të saj gjendet faire les cent pas, shkoj e vij, bëj ecejake. Kjo sipas paditëses është përdorur nga ana e të paditurve në faqen 119 duke e përkthyer njësoj si babai i saj faire les cent pas – bëj ecejake. Në fakt gjykata konstaton se bashkëautorët *** dhe *** e kanë shpejguar edhe më detaj mikrostrukturën duke shtuar fjalën lëvizje tutje –tëhu (në pritje të diçkaje). Po ashtu ka shtuar edhe shëmbull në frengjisht dhe të përkthyer në shqip.

20. Në këtë mënyrë në pjesën e mikrostrukturës “pas” ekziston edhe shprehja a deux pas që *** në fjalorin e tij e ka përkthyer është këtu afër, fare afër ndërsa në mikrostrukturën e ***-*** në faqen 119 është përkthyer dy hapa larg, as dy minuta larg, një vrap pele, fare pranë.

21. Si ky shembull dhe me të njëjtën logjikë paditësja pretendon autorsinë e 42 % të shprehjeve të përodrur në mikrostrukturat në fjalorin e të paditurve. si pronësi ekskluzive e babait të saj të paraqitura në dy fjalorët e vitit 2001, 2002 dhe për këtë arsye pretendon bashkëautorsi dhe shpërblim dëmi.

22. Së treti- Ndër të parët në Shqipëri që kanë krijuar një fjalor të tillë Fjalor shprehjesh Frengjisht Shqip “1000 shprehje me te perdorshme ne frengjishten e sotme”, botim i cili ishte realizuar nga Shtepia Botuese “****” (2008) janë të paditurit *** dhe ***. Gjykata analizon se shprehjet frazeologjike ose shprehjet popullore që ka përdorur i ati në fjalorët e përgjithshëm nuk është nën mbrojtje të së drejtës së autorit ndërsa tërësia e të gjitha fjalorit është vepër autentike dhe gjen mbrojtje nga ligji 9380/2005.

23. Nga ana tjetër fakti se shprehjet popullore në shqip që i korrespondojnë shprehjeve në frengjisht që ka lidhur *** nuk janë një punë autentike, ekskluzive e *** pasi ato janë të njohura edhe më parë nga frëngjisht folësite, nga shkrimet, nga botimeve shkencore, konferencave etj. gazetave etj. dhe paditësja nuk provoi se ai, i ati *** është përdorues për herë të parë dhe krijuesi, autori i këtyre shprehjeve që të gjente mbrojtje nga ligji. Aq më tepër që edhe bashkëautorët *** dhe *** jo vetëm kanë korresponduar këto shprehje popullore me shprehjet popullore frengjishte por kanë ilustruar edhe me shëmbuj të tjerë.

24. Nëse vazhdohet me logjikën e trashëgimtarës së *** edhe përdorimi i shprehjeve shtesë frazeologjike në fjalorin e 2008 do të kenë autorsi të veçantë ***-***. Në fakt kjo gjë nuk është e njohur në të drejtën e autorit. Pasi atashimi i një mikrostrukture e një përkthimi përkatës, shprehje frazeologjike vjen edhe nga përdorimi nga frëngjishtfolësit e mëparshëm, emisioneve në media, shkrimeve, botimeve shkencore, konferencave etj. të cilët nuk mund ti gjindet dhe as të pretendohet për autorsi përdorimi për herë të parë, porse ligji mbron veprën në tërësi kur autori strukturon, përdor një volum fjalësh, i lidh ato.

25. Së katërti- Autorisa mbi gjetjen e shprehjeve frazeologjike shqipe që i përkojnë shprehjeve frazeologjike frëngjisht nuk gjen mbrojtje nga neni 5 i ligjit të posaçëm dhe nuk është objekt i autorisë. Nga ana tjetër sipas nenit 9 të po këtij ligji, qartazi legjislatori e ka përcaktuar se ideja, koncepti pavarësisht nga mënyra e marrjes, e të shpjeguarit ose e të shprehurit nga një autor në tjetër nuk gjen mbrojtje nga ligji dhe më në detaj po ky nen shpjegon se marrja, shpjeguari dhe shprehuri qoftë edhe për shprehjet popullore (këtu futen edhe shprehjet frazeologjike sipas ekspertëve) po ashtu nuk gjen mbrojtje nga ky ligj.

26. Përkundrazi, nëse do të pranohej përkimi i disa shprehjeve nga fjalori i ***-*** tek dy fjalorët e *** dhe cënimi të së drejtës së autorit do të çertifikonim *** si pronar ekskluziv i këtyre shprehjeve frazeologjike dhe çdo person që i përdor në përkthim, në teza doktrature qoftë edhe në gjuhën e folur do të kërkonte leje përdorimi tek trashëgimtarët e ***. Kjo është arsyeja sepse përdorimi, idetë dhe mënyra e përkthimit të shprehjeve popullore por edhe çdo shprehje tjetër nuk konsiderohen si e drejtë pronësie autorsie. Përkthimi i një veprë mbrohet por nuk mbrohen fjalë të posaçme që mund t'i përkasin gjuhës shqipe dhe të përdorur nga ana e autorve të ndryshëm pasi gjuha shqipe dhe çdo komponent i saj është pronë e gjithë popullit.

27. Si përfundim, gjykata vlerëson se padia e paditësses është e pambështetur në ligj dhe në prova e si e tillë duhet rrëzuar pasi së pari *** nuk është autor i shprehjeve frazeologjike, popullore por konsiderohen jashtë të drejtës së autorit

edhe pse mund të ketë përkim në masën 11% identicitet të shprehjeve popullore dhe 6 % ngjashmëri të shprehjeve popullore mes veprave dhe së dyti në përmbajtje të tërë strukturës makro dhe mikro mes dy fjalorëve të *** ka zero ngjashmëri dhe identicitet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në Nenet 126,306 -310 , 102-106 të Kodit të Procedures Civile dhe Konventa e Bernes «Për mbrojtien e veprave letrare dhe artistike » (1971)

V E N D O S i

1. Rrëzimin e padisë së padiësit *** si e pambështetur në ligj dhe në prova.
2. Shpenzimet gjyqësore në total në ngarkim të palës paditëse, përveç shpenzimeve të ekspertëve që i ngarkohen të dy palëve në mënyrë të barabartë. Për këtë vendim lëshohet urdhëri i ekzekutimit për shpenzimet e kryera nga ana e palëve të paditura në gjykim.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brënda 15 ditëve nga nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. Për për personin e tretë ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me date 25 nëntor 2016 ora 10:26!

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

Ina Serjanaj

Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORE që i NGARKOHEN GJYQHUMBËSIT
(Sipas neneve 102 dhe 106 të K. Pr. Civile)

Taksë regjistrimi	3000 Lekë
Ekspert ***- ***lekë	
Ekspert *** - ***lekë	
Ekspert *** - *** lekë	
Taksë noteriale i paditur	*** Lekë
Për njoftime	*** Lekë

Sekretarja Gjyqësore

Ina Serjanaj